

Data 25.10.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Riparime dhe Mirembajtje e Ambjenteve per Sherbimin e URGJENCES

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 43328000-8,
44171000-9, 45311100-1, 45454100-5, 98316000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 8 120 784 (tete milion e njeqind e njezet mije e shtateqind e tetedhjet e kater) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kucove, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kucove. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 3 248 000 (tremilion e dyqind e dyzet e tetë mijë) leke.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43 dhe pika 4 e nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera 3 248 000 (tremilion e dyqind e dyzet e tetë mijë), është afërsisht 40 % e fondit limit të përcaktuar. Bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 dhe pika 4 e nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Vlera e përcaktuar e xhiros i shërben autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit të Prokurimit Publik, nenin 43 dhe pika 4 e nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe *parashikimet e legjislacionit të fushës, aktualisht nenit 29, të Ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues për gatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij Ligji.*

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e maturuara për vitin 2023.

Argumentimi: Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme :

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, si dhe :

- Situacionin përfundimtar të punimeve (për të vërtetuar natyrën e punës së kryer)
- Procesverbalin e kolaudimit (për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve)

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore si dhe :

- Situacionin përfundimtar të punimeve (për të vërtetuar natyrën e punës së kryer)
- Procesverbalin e kolaudimit (për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve)

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar, për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, pika 2.3.1 gërma a), plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2. Licenca profesionale

Operatori ekonomik ofertues, duhet të zotërojë licencë profesionale në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, e cila të përmbajë kategoritë si më poshtë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P - 1 A** Punime gërmimi në tokë;
- N.P - 2 A** Ndërtime civile e industriale;
- N.P - 11 A** Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

PUNIME SPECIALE NË NDËRTIM

- N.S - 2 A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- N.S - 4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;
- N.S - 12 A** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
- N.S - 13 A** Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni;
- N.S - 14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane..", VKM-së nr.759/2014 "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim". Licencat janë të lidhura ngushtësisht me punimet e ndërtimit dhe projektin e zbatimit dhe Ligjit

nr.10081 date 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.

Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

2.3.3. Stafi dhe punonjësit

A) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar drejtuesit teknik, që kanë në licencën e shoqërisë, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, si dhe të shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse dhe CV, si më poshtë:

- Arkitet	1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
- Inxhinier Mekanik	1 (një)
- Inxhinier Elektrik	1 (një)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder	1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Licencën profesionale dhe Cv.
- Listpagesën shoqërisë e tre muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.
Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

B) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar punonjës të kualifikuar në profesionet si më poshtë:

- Teknik Ndërtimi	1 (nje)
- Hidraulikë	2 (dy)
- Elektricistë	1 (nje)
- Hekurkthyes	2 (dy)
- Karpentier	2 (dy)
- Saldator	1 (një)
- Bojaxhi	1 (nje)
- Murator Suvatues	2 (dy)
- Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to	2 (dy)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Kodi i Profesionit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*”.

Për punonjësit me profesionet e mesiperme duhet te paraqitet listepagesa sipas periudhes se kerkuar dhe me kodin perkates te profesionit.

- a) Operatorët ekonomikë ofertues me qëllim respektimin e standardeve të sigurisë konform ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, duhet të dëshmojnë se kanë pjesë të stafit të shoqërisë *personel të trajnuar/certifikuar për punimet në lartësi (montim skeleri/punime të ndryshme fasade etj)*, jo më pak se 2 (dy) punonjës.

Për këtë duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- certifikata trajnimi për “Punimet ne lartesi D.P.I., Rënia nga lartësitë, Punimet në lartësi D.P.I. skela, shkallë, skarpate etj” e dhenë nga një organizëm certifikimi i akredituar shqiptar ose i huaj.

- b) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

- Manovrator Eskavatorist 1 (një)
- Manovrator Automakinist 1 (nje)
- Shofer 2 (dy)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratat e punës të vlefshme;

- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjetikës.

Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim jo me pak se **50 (pesedhjetë)** punonjësish, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimum sipas periudhes se sipercituar. Për plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë :

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën Gusht - Shtator 2023.
- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Gusht - Shtator 2023.

Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.3.3 (a dhe b), duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë sipas profesioneve respektive, për periudhën Gusht - Shtator 2023.

Argumentimi: Kërkesa është bazuar në pikën 4 të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 41, pika 6, shkronja b dhe c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku ky kriter lidhet ngushtësisht me objektin të kontratës *si dhe në përputhje me zërat dhe afatin e punimeve të parashikuara në preventivin dhe grafikun e punimeve*. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri një i inxhinierëve sipas profilit, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj, me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mire në kryerjen e punimeve, duke ju referuar objektit, vendndodhjes gjeografike. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast mund të çojë në mosrealizim në afat dhe me cilësi të dobët të punimeve. Personeli teknik i inxhinierëve, kapacitetet dhe aftësitë organizative janë të domosdoshëm për realizimin të kontratës.

- C) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar punonjës të kualifikuar/certifikuar, si dhe të figurojnë në listpagesat për tre muajt e fundit, si më poshtë:
- 1 (një) punonjës që të disponojnë certifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.
 - 2 (dy) punonjës me certifikatë trajnimi për punimet në lartësi D.P.I. (montim skeleri, punime të ndryshme fasade, etj.) e dhënë nga një organizëm i akredituar, shqiptar ose i huaj.

Argumentimi: Në mbështetje të ligjit Nr.10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe VKM-në Nr.312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier”, si dhe Nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar.

2.3.4. Mjetet dhe paisjet

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë mjetet dhe pasijet e nevojshme për realizimin në kohë dhe me sukses të punimeve, si më poshtë:

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
4	Minieskavator	2 copë	Në pronësi ose me qera
5	Autobetoniere	2 copë	Në pronësi ose me qera
6	Autopompë betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Kamion me vinxh	1 copë	Në pronësi ose me qera
8	Elektrosaldatriçe	1 copë	Në pronësi ose me qera
9	Moto gjenerator	1 copë	Në pronësi ose me qera
10	Depozite uji	3 copë	Në pronësi ose me qera
11	Vibrator betoni	2 copë	Në pronësi ose me qera
12	Betoniere kantieri	2 copë	Në pronësi ose me qera
13	Kokore	25 copë	Në pronësi ose me qera
14	Tranxhe për perpunimin e hekurit te ndertimit	1 copë	Në pronësi ose me qera
15	Skeleri Ndertimi	500 m2	Në pronësi ose me qera
16	Pompe suvatimi	1 cope	Në pronësi ose me qera
17	Kontenier ndërtimi stacionar (zyrë)	1 copë	Në pronësi ose me qera

(a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- *dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit, (çertifikata e pronësisë);*
- *dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit);*
- *çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);*
- *siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;*
- *leje transporti e vlefshme nga njësi vendore (sipas rastit)*
- *foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij;*

(b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në perfundimin e plotë të punimeve.

(c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- *kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse*

- fotot

(d) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë kur janë me qira, krahas dokumentacionit të mesipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në perfundimin e plotë të punimeve.

Argumentimi: Kërkesa është bazuar në pikën 4 të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 41, pika 6, shkronja ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kriteri është në përputhje me zërat dhe afatin e punimeve të parashikuara në preventivin dhe grafikun e punimeve. Gjithashtu është në përpjesëtim me natyrën, zërat e punimeve dhe vlerën e kontratës. Operatorët ekonomik kërkesat për pajisjet në pronësi, mund të plotësojnë edhe duke marrë ato me qira. Lidhur me paisjet Autoriteti Kontraktor ka patur parasysh projektin, preventivin dhe relacionin teknik. Këto paisje mund të sigurohen lehtësisht nga operatori ekonomik pasi janë me kosto relativisht të ulët dhe nuk përbëjnë kriter diskriminues.

2.3.5. Kërkesat e cilësisë dhe standarteve

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të vlefshme për periudhën e ndërtimit, si më poshtë **ose ekuivalente me to:**

- ISO 9001:2015 Sistem i Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 45001-2018 Sistem i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë
- ISO 14001-2015 Sistem i Menaxhimit Mjedisor për Kompaninë
- ISO 39001:2021 Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në trafikun rrugor
- ISO 50001 : 2018 Sistemin e Menaxhimit të Energjisë për Kompaninë

Argumentimi: Bazuar në ligjin. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 79 dhe neni 77 pika 4, në të cilin thuhet: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”, si dhe të VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 44 pika 1, AK kërkon cilësi dhe garanci të punimeve duke qenë se objekti është i një rëndësie të veçantë. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminues për operatorët.

Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin :

- “*Planin e Sigurisë në Kantier*” për punimet në objekt në format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “*Për masat e vecanta të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit në punë*”, të ndryshuar me VKM-në Nr.742 datë 06.11.2003.
- *Planin e Sigurisë në Kantier* për punimet në objekt në format sipas VKM nr.692 date 13.12.2001 “*Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr.742 date 06.11.2003.Nje pershkrim i detajuar te planit te Zbatimit te Kerkesave per Sigurimin Teknik dhe Shendetit ne Pune (Health, Safety and Environment HSE) ne perputhje me planin e Menaxhimit te Sigurimit Teknik dhe Shendetit ne Pune.*

2.3.6 Për ato zëra punësh që nuk ndodhen në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, ofertuesit duhet të paraqesin analizat teknike të tyre, sipas formatit të miratuar.

2.3.7 Vetëdeklarim, sipas deklaratës në vijim, ku të evidentohen objektet dhe vlerat përkatëse të kontratave, nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

NJËSIA E PROKURIMIT

Armando Pepa

Aurora Daulle

Marjo Hajdari